FORMULAR PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË TELEKOMUNIKACIONIT

Datë

1. Të dhëna (për tu plotësuar nga Trinet ose Distributori).

Emri i distributorit:

Kodi i distributorit:

Numri i Kontrates:

Kodi i Klientit:

Kategoria e klientit:	Lloji Veprimtarise:	**NIPT**:

2. Të dhënat e klientit

Emri:	Mbiemri:	Emri Babait:
Adresa:		
Shteti:	Qyteti:	Zona:
Telefon:	Email:	ID:

3. Të dhënat e klientit

Adresa ku do te ofrohet shërbimi:

Sherbimet e ofruara	Lloji I IP-se	Paketa e Telefonise
Fushata	**Si degjuat per Trinet**	**Fushata per referuesit**

4. Detajet per sherbimin (Per tu plotesuar nga Trinet)

5. Vlera e sherbimit

Teknologjia	Modeli I Paisjeve	Kosto Instalimi	Pagese Mujore

6. Info per pagesen

Cash	POS	Banke

7. Pranimi i kushteve te kontrates dhe firmes

1. *Unë kam lexuar dhe kuptuar të gjitha kushtet dhe termat e përshkruara të kësaj Kontrate, sic përcaktohet në faqet bashkëngjitur këtij formulari.*
2. *Unë pranoj të gjitha tarifat dhe pagesat për të gjitha shërbimet e ofruara sipas këtij aplikimi.*
3. *Unë kam lexuar dhe jam dakort me cmimet e ASC, karakteristikat dhe kufizimet e shërbimeve të ofruara.*
4. *Deklaroj se i gjithë informacioni i lartpërmendur është i saktë.*

ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS ASC Sh.p.k.

Firma e Përf të Shitjeve	Data	Emri dhe Mbiemri i Klientit	Firma e klientit dhe vula

Kujdesi per Klientin ne Trinet: +35544800000 – support@trinet.al

TERMA TË PËRGJITHSHËM

1.1 Kjo marrëveshje lidhet me vullnetin e plotë dhe të lirë të të dyja palëve për përcaktimin e termave, të drejtave dhe detyrimeve dhe anasjelltas në kuptim të zbatimit të tyre në përputhje me ligjin 54/2024 datë 30.05.2024 "Për Komunikimin Elektronik në Republikën e Shqipërisë", ligjin 97/2013 datë 04.03.2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjin 124/2024 datë 19.12.2024 "Për Mbrojtjen e të dhënave Personale "ligjit Nr. 9902 datë 17.04.2008 "Për Mbrojtjen e Konsumatorëve" dhe Ligjin Nr. 35/2016 date 31.03.2016 "Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejta të tjera të lidhura me të", ndryshimet e aplikuara kohë pas kohe mbi këto Ligje, si dhe në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë

1.2 Shoqëria "Albanian Satellite Communications" sh.p.k,me adresë: Rruga "Fabrika e Qelqit", Zona Kadastrale 8230, Nr.Pas.2/63, Tiranë, Regjistruar sipas Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane me Nr. 36243 datë 24.07.2006, me NUIS K62115018I, operon në fushën e telekomunikacionit, e autorizuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare "AKEP", me Çertifikatë të Konfirmimit të Njoftimit Nr.2012-AP-U144-8-5 datë 30.03.2012, duke pasur të drejtën për të ofruar Shërbimin publik telefonik të qëndrueshëm/në linjë fikse, shërbimin e aksesit në Internet si dhe shërbime audiovizive, sipas marrëveshjëve me palët e treta të autorizuara, me poshtë quajtur "Shërbimi".

PËRKUFIZIME

Kontratë - nënkupton marrëveshjen me shkrim midis Operatorit dhe Pajtimtarit.
Operator - nënkupton personin juridik i cili ofron shërbimin sipas përcaktimeve të kësaj kontrate.
Pajtimtar- nënkupton personin juridik ose fizik i cili përfiton shërbimin e ofruar në bazë të termave dhe kushteve të kësaj kontrate.
Palë (ët) - nënkupton Operatorin dhe/ose Pajtimtarin vec e vec ose së bashku.
Shërbimi i aksesit në internet- është shërbimi i komunikimeve elektronike i disponueshëm për publikun që ofron akses në internet, dhe rrjedhimisht lidhje në virtualisht të gjitha pikat fundore të internetit, pavarësisht teknologjisë së rrjetit dhe pajisjes fundore të përdorur.
Shërbim Telefonie - rrjet telekomunikacioni.
Shërbim programi audioviziv- program audioviziv në rrjetin e të tretëve.
Shërbim e-maili - mënyre komunikimi për të transmetuar të dhëna elektronike.
Shërbim i bartjes (portimit) të numrit – ndryshimi i Operatorit telefonik, duke mbajtur të njëjtin numër.
Pika Ndarëse - pika në të cilën kontrolli operacional ose pronësia e pajisjeve të komunikimit ndryshon nga njëra palë tek tjetra. Pika Ndarëse zakonisht është pika ndërmjetëse, nga pajisjet në ambjentet e Pajtimtarit (CPE) tek rrjeti i jashtëm që vjen nga Operatori. Në rast se pajisja (CPE) është pronësi e Operatorit, ose e dhënë me qira nga Operatori atëherë kjo do të konsiderohet si Pika Ndarëse. Në gjitha rastet e tjera pika e ndarjes është kutia ku përfundon kablli i telekomunikacionit.
"Mjet i qëndrueshëm" - është çdo mjet, i cili i mundëson konsumatorit/pajtimtarit apo ofruesit të shërbimit publik të komunikimeve elektronike ruajtjen e informacionit të drejtuar personalisht atij, në mënyrë që të lejojë referimin për qëllime informimi, në të ardhmen, për një periudhë kohe të përshtatshme, dhe që lejon riprodhimin e pandryshuar të informacionit të ruajtur.
Me këtë term nënkuptohet cdo mjet komunikimi (media) dhe përfshin në vecanti letër, USB, CD-ROM, kartë memorie ose hard disk të kompjuterit si dhe e-mail. Gjithashtu njoftimi me SMS përbën mjet të qëndrueshëm në lidhje me njoftimin, pasi SMS i drejtohet personalisht pajtimtarit dhe ky i fundit ka mundësi ta ruajë për një periudhë kohe të përshtatshme. Por nëse në SMS përfshihet një hyperlink që drejton pajtimtarin në faqen e internetit të operatorit me informacion shtesë, informacioni në faqe të internetit nuk përbën mjet të qëndrueshëm, pasi ky informacion në website mund të ndryshohet në mënyrë të njëanshme nga operatori në cdo kohë. Ndërsa, dhënia e informacionit në llogarinë online të pajtimtarit apo nëpërmjet aplikacionit të operatorit që mund të aksesohen në mënyrë individuale dhe të sigurt nga pajtimtari, përbëjnë shembuj të mjetit të qëndrueshëm.
"Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare" (AKEP) është organi rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar, i cili mbikqyr kuadrin rregullator të përcaktuar nga 54/2024, nga ligji për shërbimin postar dhe nga politikat e zhvillimit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

2. OBJEKTI I KONTRATËS

2.1 Kjo kontratë përcakton kushtet, afatet, të drejtat dhe detyrimet që palët do të kenë kundrejt njëra-tjetrës si rrjedhojë e përdorimit nga pajtimtari të njërit prej ose të gjitha shërbimeve, të listuara si në vijim:

- Shërbim aksesi në internet
- Shërbim publik telefonik të qëndrueshëm/në linjë fikse
- Shërbim të programeve audiovizive
- Shërbim emergjence pa pagesë (free)
- Shërbimi i portabilitetit të numrit sipas parashikimeve të Ligjit 54/2024 dhe

Rregullores 13 datë 16.04.2010 ,Rregullores 43 01.07.2018 dhe 49 datë 11.03.2021 -te AKEP dhe ndryshimeve përkatëse.

Shërbim konsiderohetlidhja e Pajtimtarit me rrjetin e Ofruesit të Shërbimit, nëpërmjet të cilit mundësohet shërbimi i kërkuar, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë kontratë, për Pajtimtarin.

Tarifat dhe Shërbimet

1. Shërbimet dhe tarifat e tyre, të ofruara nga Operatori dhe të pranuara nga ana e pajtimtarit, paraqiten dhe nënshkruhen sipas Aneksit 3 të kësaj Kontrate dhe janë pjesë integrale e Kontratës së nënshkruar midis palëve.

Tarifat dhe shërbimet publikohen gjithashtu në faqen zyrtare të Operatorit, sipas parashikimeve ligjore.

2. Tarifat e shërbimeve janë objekt ndryshimi, të cilat vendosen dhe publikohen sipas kërkesave të Ligjit Nr, 54/2024"Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë".

3. KOHËZGJATJA E KONTRATËS

3.1 Kjo kontratë nënshkruhet për një afat fillestar 1 (një) vjeçar, sipas tarifave standarte të shërbimit të ofruara nga Operatori. Në rast se pajtitmari preferon dhe dëshiron tarifa preferenciale, afati i kontratës do të jetë sipas ofertave të përcaktuara në Aneksin 3 që i bashkëngjitet kësaj kontrate. Nëse palët nuk njoftojnë njëri tjetrin me shkrim deri 30 ditë para përfundimit të afatit fillestar të kontratës ajo do të rinovohet automatikisht, për një afat ta pacaktuar. Në këtë rast tarifat e shërbimit të ofruar, në vazhdim të afatit të pacaktuar, do të jenë tarifat e aplikuara nga Operatori, në momentin e rinovimi të kontratës dhe të publikuara. Nëse Pajtimtari kërkon të përfundojë kontratën para përfundimit të afatit kontraktor fillestar, duhet të paraqesë 30 ditë përpara një letër njoftimi me shkrim, për ndërprerjen e kontratës duke qënë i detyruar të paguajë vlerën mujore të shërbimit përkatës për muajt e mbetur, deri në përfundim të afatit të saj. Mbas përfundimit të afatit fillestar të kontratës, Pajtimtari ka të drejtën të ndëpresë kontratën në cdo kohë duke njoftuar me shkrim të paktën 30 (tridhjetë) ditë para, pa asnjë penalitet.

4. TERMAT E PAGESËS

4.1 SHËRBIMI ME PARAPAGIM

4.1.1 Pagesa fillestare të parashikuara për shërbimet e ofruara do të përcaktohen në Ankesin bashkëngjitur kësaj kontrate.

4.1.2 Pajtimtari me nënshkrimin e kontratës angazhohet të paguajë vlerën totale vjetore e llogaritur mbi ofertën e aplikuar, e cila është e pagueshme për 12 muaj. Në rast se Pajtitmari brenda afatit fillestar të kontratës për 12 muaj, nuk kryen pagesa të rregullta te njëpasnjëshme Operatorit i lind e drejta e aplikimit të pagesës për ditët e papaguara.

4.1.3Të gjithë pagesat e muajve në vazhdim do të kryhen, sipas përzjedhjes së pajtitmarit, si në vijim:

Shërbim Interneti

Data e kryerjes së instalimit për shërbimet internet do të konsiderohet si dita e parë e ofrimit të shërbimit për Pajtimtarin. Për çdo muaj të parapaguar, gjatë 5 (pesë) ditëve të fundit të tij , Pajtimtari do të njoftohet dhe duhet të kryejë pagesën për ofrimin e shërbimit për muajin në vazhdim. Në adresën e e-mailit të çdo Pajtimtari, gjatë periudhës së mësipërme do të dërgohet nga Operatori njoftim kujtesa për kryerjen e pagesës mujore. Pajtimtari ka përgjegjësinë të kryejë pagesën në afatet e caktuara, në mënyrë që të mos humbasë shërbimin që i ofrohet. Nëse Pajtimtari nuk kryen pagesën në periudhën e mësipërme, atëherë Operatori do të ndërpresë shërbimin përkatës për muajin në vazhdim, duke e konsideruar këtë si një ndërprerje të njëanshme të kontratës së nënshkruar. Në këtë rast Operatorit i lind e drejta të kërkojë penalitet përkatëse për ndërprerjen e kontratës para afatit, në mënyrë të njëanshme dhe të pa justifikuar

Shërbim telefonie

Operatori i ofron Pajtimtarit mundësi kreditimi me pagesë për shërbimin e telefonisë. Për këtë shërbim Pajtimtari duhet të paraqitet në një nga pikat shërbimit të Operatorit, për të kryer pagesën përkatëse në varësi të së cilës Pajtimtari kreditohet për shërbimin e ofruar. Nëse Pajtimtari nuk paraqitet për të kryer pagesë për kreditimin e shërbimit, ai nuk mund të kryeje asnjë telefonatë nëpërmjet numrit të telefonisë së ofruar në momentin e nënshkrimit të kontratës, përvec shërbimeve të emergjencës, të cilat janë shërbime pa pagesë. Kreditet e paguara për ofrimin e shërbimit të telefonisë kanë afat 6(gjashtë) muaj nga momenti i kreditimit ose i rimbushjes. Përtej këtij afati, çdo kredit i mbetur nuk do te jetë më vlefshëm.

Nëse Pajtimtari dëshiron, në fund të çdo muaji i ofrohet një tabelë analitike për telefonatat e realizuara gjatë muajit, për të gjitha kreditimet e kryera nga ana e tij. Ky informacion do të dërgohet në adresën e tij të e-mailit.

4.2 SHËRBIMI ME PASPAGIM

4.2.1 Pagesa fillestare e instalimit dhe pagesa për muajin e parë duhet të kryhet në momentin e nënshkrimit të kontratës, ose sipas parashikimeve të ofertave përkatëse të përzgjedhura nga vetë pajtimtari.

4.2.2Të gjithë pagesat e muajve në vazhdim do të kryhen si më poshtë:

brënda 10 ditëve të para të muajit në vazhdim Operatori duhet të dërgojë faturën e muajit të mëparshëm duke detajuar shumën totale të shërbimit të siguruar. Nëse Pajtimtari kryen një sasi telefonatash të barabartë me vlerën limit të përcaktuar në marrëveshje me Pajtimtarin, duhet të kryejë këtë pagesë brënda 48 orëve nga momenti i njoftimit për arritjen e këtij limiti, në të kundërt Operatori ruan të drejtën të shkëpusë përkohësisht shërbimin deri në momentin që Pajtimtari kryen pagesën e mësipërme.

4.2.3 Operatori ofron cdo muaj faturën përkatëse, që Pajtimtari duhet t'i paguajë Operatorit për shërbimin e ofruar sipas kësaj kontrate, ku pasqyrohet në mënyrë të detajuar:

a) periudha e faturimit
b) pagesë fikse mujore për shërbimin
c) lloji dhe shuma e të gjitha pagesave të tjera të mundshme për periudhën e faturimit,
ç) për shërbimin telefonik përfshihen numrat e thirrur, data, ora si dhe kohëzgjatja e bisedave të kryera
d) pagesa përkatëse për çdo komunikim të kryer.

Fatura, emetohet dhe i dorëzohet pajtimtarit në vendin e ofrimit të shërbimit, ose në adresën e specifikuar prej tij si dhe në adresën e emailit të deklaruar në kontratë, në mënyrë zyrtare (me postë/postë elektronike ose dorazi) dhe jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike përpara afatit të pagesës së saj.

Pajtimtari duhet të kryejë pagesën mujore në cash pranë pikave të shitjes së Operatorit apo pikave të autorizuara prej tij, me Kartë Kredi në numrin e llogarisë Bankare të Operatorit, ose në forma të tjera të ndryshme nga këto, brenda datës së 25(njëzetë e pesë) të muajit, në vazhdim. Pajtimtari duhet të marrë dhe të ruajë kopjen e tij të dokumentave, që vërtetojnë kryerjen e veprimeve financiare për pagesën e faturës.

Operatori brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas afatit të pagesës, do të njoftoje Pajtimtarin me shkrim ose me SMS/telefonatë nëpërmjet Call Center(kujdesi për Pajtimtarin) për plotësimin e detyrimit të pagesës apo detyrimeve të tjera kontraktore, brenda një afati të arsyeshëm, jo më pak se 15 ditë, të përcaktuar nga Operatori si edhe duke e paralajmëruar Pajtimtarin për masat kufizuese që mund të ndërmarrë Operatori.

Në rast se Pajtimtari nuk kryen pagesën apo nuk përmbush detyrimet kontraktore brenda 30 (tridhjrtë) ditëve nga afati i pagesës se faturës,Operatori ka të drejtë të kufizoje apo ndërpresë përkohësisht ofrimin e shërbimeve. Në këtë rast Operatori do të të dërgoje një njoftim për paralajmërimin e fundit dhe/ose fillimin e masave kufizuese/ndërprerjes së përkoheshme apo përfundimtare.

Nëse pajtimtari përmbush shlyerjen e detyrimit, Operatori do të riaktivizojë shërbimin brenda 2 (dy) orëve nga momenti që Pajtimtari ka dorëzuar mandat pagesën përkatëse.

Në rast se Pajtimtari nuk ka paguar detyrimin 30 (tridhjetë) ditë pas afati të pagesës së faturës, Operatori ka të drejtë të konsiderojë këtë si ndërprerje e kontratës në mënyrë të njëanshme dhe të pajustifikuar, duke i dërguar njoftim Pajtimtarit 10 (dhjet) ditë përpara ndërprerjes. Pas kësaj date me shlyerjen e të gjitha detyrimeve ndaj Operatorit, Pajtimtari ka të drejtë të riaktivizojë shërbimin sipas Kontratës së Pajtimit, e cila e fillon afatin nga data e parë e mospagesës.

5.TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PAJTIMTARIT

5.1 Pajtimtari duhet të veprojë në përputhje me ligjet dhe rregullat e përdorimit të shërbimeve të telekomunikacionit, dhe nuk duhet të veprojë në mënyrë joligjore ose të papërshtatshme që dëmtojnë Pajtimtarët e tjerë, Operatorin, ose një nga shërbimet e tjera të ofruara nga Operatori. Veprime të papërshtatshme nënkuptojnë, por pa u kufizuar në to:

5.1.1 Ndonjë tentativë për të lokalizuar ose identifikuar të dhënat personale të përdoruesve të tjerë në rrjet (emri përdoruesit/fjalëkalimi).
5.1.2 Ndonjë tentativë për kalim të paautorizuar në të dhënat ose sistemet e përdorura për parashikimin e shërbimeve.
5.1.3 Trasmetimin e mesazheve të konsideruara si bulk-emaile në listën përdoruesve të e-maileve pa miratimin paraprak të tyre (spamming).
5.1.4 Ndonjë tentativë për të ndërprerë përdorimin nga palët e tjera (mospranim i sulmit të shërbimit).
5.1.5 Ndonjë veprim jo ligjor si shpërndarja joligjore, e piratuar e materialeve pornografik.

5.2 Emri i Pajtimtarit/ Fjalëkalimi i të dhënave janë ofruar për përdorim ekskluziv të Pajtimtarit.
5.3 Interneti është Medie e Lirë. Pajtimtari duhet të përdorë në mënyrë të kujdesshme shërbimin dhe të parandalojë përdorimin nga fëmijet të materialeve të dëmshme. Në të gjitha raste Operatori nuk mban përgjegjësi për përdorimin dhe ose aksesin në materialet joligjore ose ofenduese, gjithashtu në mos zbatimin e ndonjë filtrimi të mundshëm.
5.4 Pajtimtari detyrohet të mos kryejë dhe të mos lejojë kryerjen e veprimeve që Operatori çmon se mund të ndikojnë ose të venë në rrezik cilësinë e rrjetit dhe dhënien e shërbimeve. Pajtimtari është i detyruar të mos kryejë pirateri informatike/audiovizive nëpërmjet shërbimit të ofruar. Në rast të konstatimit të veprimeve të tilla, si dhe në cdo rast kur Pajtimtari

sillet në mënyrë joligjore kundrejt Pajtimtarëve të tjerë dhe kundrejt Operatorit, Operatori ruan të drejtën të ndërpresë shërbimin dhe njëkohësisht t'i drejtohet Gjykatës për shpërblimin e dëmit përkatës.

5.5 Pajtimtari duhet të njoftojë Operatorin përpara se të kryejë ndryshimin e pajisjes (router, pc, kartë rrjeti, etj. nëse këto pajisje janë vendosur nga Operatori) me anë të së cilës lidhet me rrjetin e Operatorit. Pajtimtari detyrohet të njoftojë Operatorin për çdo ndryshim të të dhënave vetiake të paraqitura në këtë Kontratë brenda 5 (pesë) ditëve.

5.6 Shërbimi i ofruar nga Operatori është për përdorim ekskluziv të tij. Pajtimtari nuk ka të drejte të rishesë, rishpërndarje ose të përdorë shërbimin për qëllime tregtie. Në mënyrë të shprehur Pajtimtarit nuk i lejohet të përdorë shërbimin për të realizuar thirrje automatike, shitje televizive, marketing televiziv, apo dërgim masiv nëpërmjet faksit. Pajtimtari nuk lejohet të ofrojë shërbime (me ose pa pagesë) tek rezidentët e tjerë ose palëve të treta jashtë vendit. Pajtimtari nuk ka të drejte të dhurojë, lëviz, japë me qira ose të shesë tek palët e treta.

5.7 Pajtimtari detyrohet, nëse është e nevojshme dhe në koordinim me Operatorin, të lejojë të verë në dispozicion të personelit të Operatorit ambientet e tij, që të kryejë instalimin e rrjetit të telekomunikacionit, mirëmbajtjen dhe riparimin rrjetit që i shërbejnë ofrimit të shërbimit të telekomunikacionit. Në rast se Pajtimtari pengon personelin e Operatorit që të kryejnë instalimin e shërbimit, Operatori ka të drejtën të konsiderojë këtë veprim si ndërprerje të menjëhershme dhe të pajusitifkuar të kontratës, duke rezeveruar të drejtën e zbatimit të penalitetit. si në rastin e ndërprerjes së kontratës para afatit fillestar. Gjithashtu ai është i detyruar të mbajë në kushte të mira kabllin lidhës brënda ambjenteve të tij. Kjo pjesë e lidhjes është pronësi e Pajtimtarit dhe Pajtimtari ka përgjegjësinë të riparojë dëmet. Operatori nuk mban përgjegjësi për mos ofrimin e shërbimit në rast se ndërprerja ndodh për arsye të dëmeve në lidhjen e brëndshme.

Pajtimtari është përgjegjës kundrejt Operatorit në lidhje me sigurimin e lejes dhe autorizimit nga palët e treta për punët e përmendura më sipër, në rast se këto palë kanë të drejtë të refuzojnë kryerjen e këtyre punëve si në ambjentet e Pajtimtarit ashtu dhe në ndërtesën e Pajtimtarit ose në pronësine e përbashkët.

5.8 Pajtimtari nuk mund t'jua kalojë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo kontratë të tretëve.

5.9 Të mos përdorë dhe të mos lejojë persona të tretë të përdorin shërbimin e ofruar nga shoqëria për qëllime që bien ndesh me moralin dhe me ligjin.

5.10 Për shërbim e-mail Pajtimtari ka këto të drejta dhe detyrime:

Të mos përdorë shërbimet e- mail për t'u bërë pjesëtare ose të ndihmojë të tjerët të bëhen pjestarë në sjellje ilegale ose abuzuese, përfshirë këtu pa përjashtim paragrafët e mëposhtëm:

5.10.1 Ngarkimin, postimin ose transmetimin e ndonjë përmbajtjeje që është e paligjshme, dëmtuese,kërcënuese, shpërdoruese,vulgare, ndërhyrëse në privatësine e tjetrit, urrejtëse ose raciale, etnike ose përndryshe e papranueshme, sipas gjykimit tone.

5.10.2 Dëmtimin e fëmijëve në çdo lloj forme.

5.10.3 Të imitosh ose sillesh si një person ose biznes përfshirë këtu dhe jo vetëm e kufizuar në një forum, guide, ose të keqpërfaqësosh lidhjen tënde me këtë person apo biznes.

5.10.4 Të fshish ose të manipulosh të dhënat emërore të dërguesit, adresat IP, emrat e serverave, adresat e email-it, në mënyrë që të zhduket origjina e çdo përmbajtjeje.

5.10.5 Ngarkimin , dërgimin apo transmetimin e ndonjë përmbajtjeje që ju nuk keni të drejta për të transmetuar përkundrejt çdo ligji apo marrdhënie besimi (siç është një informacion i brëndshëm, personal apo konfidencial mësuar apo i nxjerrë si pjesë e marrëdhenieve të punësimit ose nga ndonjë marrëveshje për mos nxjerrje informacionin).

5.10.6 Ngarkimin,dërgimin,apo transmetimin e çdo përmbajtjeje që dhunon një patent apo markë të rregjistruar, të drejtën e autorit, publicitet apo të drejta pronësie të çdo pale.

5.10.7 Ngarkimin, dërgimin apo transmetimin e çdo reklame të paautorizuar,materialeve promocionale,emaileve të parëndësishme,skemave piramidale apo çdo lloj forme tjetër përveç atyre zonave të shërbimit që janë caktuar për këtë qëllim.

5.10.8 Ngarkimin,dërgimin,apo transmetimin e çdo materiali që përmban viruse të softëare-ve dhe çdo kodi kompjuterik ose programeve të përcaktuara për të ndërprerë, shkatërruar ose kufizuar funksionet e çdo kompjuteri ose pajisje telekomunikuese.

5.10.9 "të marrësh peng" ose të mërzisësh një tjetër.

5.10.10 Të mbledhësh ose të ruash të dhëna personale për përdoruesit e tjerë.

5.10.11 Shitja, shkëmbimi ose shpërndarja tek një palë e tretë të adresës së emailit të një personi pa njohurinë dhe aprovimin e personit në fjalë për ta nxjerrë këtë adresë.

5.10.12 Pajtimtari ka të drejtën të përdorë shërbimin e Portimit të numrit, duke plotësuar të dhënat dhe kërkesën sipas parashikimeve të Rregulloreve përkatëse për protimin e numrit. Në këtë rast Operatori nëse është në rolin e Operatorit Marrës ka detyrimin të ndjekë të gjithë procesin dhe plotësimin e të gjithë dokumentacionit të duhur për realizimin e portimit të numrit, sipas kërkesës së Pajtimtarit.

6 . TË DREJTAT DHE DETYRIMET E OPERATORIT

Shërbimi Internet dhe Telefoni

6.1 Operatori detyrohet të ofrojë shërbim telekomunikacioni dhe interneti 24 orë/ditë, sipas standarteve teknike dhe cilësisë së shërbimit të përcaktuar në këtë kontratë.

6.2 Operatori detyrohet t'i sigurojë mbështetje teknike Pajtimtarit për problemet e lidhura me shërbimin e ofruar. Operatori mund të ofrojë mbështetje teknike kundrejt pagesave shtesë, pas evidentimit të problemit që ka ndodhur, në rast se ky problem nuk përfshihet në përgjegjësitë e Operatorit dhe fillon mbas pikës ndarëse.

6.3 Operatori ka detyrimin të riparojë defektet teknike dhe të rivendosë ofrimin e shërbimit brenda 3 (tre) ditëve kalendarike, llogaritur nga momenti i njoftimit në numrat e informacionit të Operatorit.

6.4 Ne rast se problemi zgjat më shumë se 3 (tre) ditë nga momenti i njoftimit të problemit, Ofruesi i Shërbimit është i detyruar të llogarisë pagesën deri në momentin që Pajtimtari ka përdorur shërbimin objekt kontrate , si dhe dëmshpërblimin për shërbimin e munguar.

6.5 Në rast se shërbimi i kontraktuar nuk plotëson nivelin e cilësisë së parashikuar në kontratë dhe/ose Operatori vonon riparimin e defekteve në rrjetin e tij të telekomunikacioneve, tej afateve të përcaktuara në Aneksin përkatës të kësaj kontrate, atëherë ai detyrohet t'i zbresë faturës së muajit në vijim 3% të tarifës së pajtimit mujor apo tarifës fikse (me TVSH) të shërbimit që ofrohet, për cdo ditë mungese cilësie/vonese riparimi defekti ,por jo më shumë se vlera e tarifës se pajtimit mujor apo tarifës fikse (me TVSH).

6.6 Operatori detyrohet të shqyrtojë menjëherë çdo kërkesë ose ankesë të Pajtimtarit dhe të zgjidhë çdo cështje ose mosmarrëveshje që ka lidhje me dhënien dhe cilësine e shërbimeve të përcaktuara në këtë Kontratë Shërbimi.

Pajtimtari duhet të bëjë të ditur dhe të raportojë tek Operatori problemin me detaje, nëpërmjet e-mailit apo duke telefonuar në Departamentin e Suportit Teknik. Operatori nuk mban përgjegjësi për zgjidhjen e problemit, ose në angazhimin për zgjidhjen e problemit nëse Pajtimtari raporton problemin në ndonjë mënyrë tjetër përveç asaj të përmendur më sipër.

6.7 Operatori garanton se nuk do të cënojë lirinë dhe fshehtësinë e korrespondencës së Pajtimtarit.

6.8 Operatori ka të drejtën të modifikojë pa njoftim paraprak karakteristikat e shërbimit. Në cdo rast modifikimi nuk do të dëmtojë shërbimin e ofruar.

6.8.1 Të aplikojë rritjen e tarifës së një apo më shumë shërbimeve të zgjedhura nga pajtimtari në kontratë , vetëm pas ezaurimit të procesit të njoftimit të pajtimtarit nga Operatori:
- Nëpërmjet njoftimit me e-mail, SMS apo telefonatë nëpërmjet Call Center, të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara hyrjes në fuqi të tyre, në rastin kur rritja e tarifave publikohet nga Operatori. Njoftimi individual duhet të përfshijë adresen se ku jane publikuar rritjet e tarifave, në rast se njoftimi nuk përmban detaje të mjaftueshme të ndryshimeve;
- Nëpërmjet mjeteve të informimit publik , jo më pak se 7 (shtatë) ditë përpara hyrjes në fuqi të tyre dhe ky njoftim duhet të bëhet për jo me pak se 3 (tre) ditë rrjesht, në rastin kur rritja e tarifave është miratuar nga AKEP me një vendim të veçantë.

6.8.2 T'i japë Pajtimtarit informacion të detajuar për programet tarifore që mund të zgjedhë pajtimtari , duke i dhënë mundësinë e krahasimit midis tyre, përfshirë;
i) Informacion të plotë dhe të qartë, për paketat tarifore dhe ofertat promocionale apo speciale si zbritjet e tarifave, trafik i pakufizuar, kohën e kryerjes së thirrjeve, duke specifikuar midis të tjerave cfarë përfshihet në paketë/ofertë dhe cfarë nuk përfshihen në to, afatet kohore të ofertave dhe efektet e tejkalimit të tyre, përfshirë tarifat e aplikuara;
ii) Sistemin tarifor të aplikuar për shërbimet si koha minimale e tarifimit , mënyra e tarifimit pas kohës minimale , njësia e matjes për tarifimin (p.sh sekonda, intervale kohore, M/byte etj.), ndryshimi i tarifës me kohëzgjatjen, koha e kryerjes së thirrjes (peak/off peak) dhe intervalet përkatëse kohore të tyre, etj.
iii) Shërbimet shtesë të përfshira në paketën e zgjedhur
iv) Informacion për cilësinë e shërbimeve të ofruara/zgjedhura përfshirë informacion dhe sqarime për shpejtësinë e internetit.

6.8.3 Të kryejë njoftimin e pajtimtarit nëpërmjet e-mailit apo komunikimit me SMS, kur arrihet niveli 80% i kufizimit "download"/upload"(nëse ka të tillë) të përcaktuar në Aneksin 1 të kësaj Kontrate.

6.8.4 Sipas kërkesës së pajtimtarit, të lejojë mbarjtjen e numrit të alokuar në rast të ndryshimit të operatorit ,apo edhe vendodhjes nëse është e aplikueshme (portabiliteti i numrit) dhe të lejojë përdorimin nga pajtimtari të shërbimeve të zgjedhjes dhe/ose parazgjedhjes së bartësit të thirrjeve (nëse një detyrim i tillë i është vendosur operatorit nga AKEP), në përputhje me legjislacionin dhe kuadrin rregullator në fuqi.

6.8.9 Ka detyrimin të ndjekë procedurat e portimit të numrit nga Operatori dhënës, nëse kjo gjë kërkohet nga pajtimtari, duke zbatuar të gjitha parashikimet ligjore për këtë proces, sipas formularëve përkatës të miratuar nga AKEP, nëpërmjet Rregulloreve përkatëse. I gjithë informacioni i duhur vihet në dispozicion të Pajtimtarit, në pikat e shitjes dhe ato të autorizuara nga vet Operatori.

6.8.10 Operatori do të ofrojë Shërbimet e saj 24 (njëzet e katër) orë në ditë për 7 (shtatë) ditë në javë, pa ndërprerje, me përjashtim të ndërprerjeve të përkohshme të shërbimit të ardhura si rezultat i punimeve të domosdoshme të mirëmbajtjes së rrjetit, në përputhje me standartet e vendosura në autorizimin lëshuar nga AKEP, orë të cilat do të jenë të programuara në mënyrë të tillë që t'u shkaktojnë sa me pak shqetësime Pajtimtarëve.Pavarësisht të gjitha parashikimeve orët e punës për mirëmbajtje, nuk do të konsiderohen si mungesë shërbimi dhe nuk do të jenë objekt kompesimi nga ana e Operatorit kundrejt Pajtimtari.

7. ZGJIDHJA DHE INFORMACION TEKNIK dhe CILESIA

7.1 Pajtimtari nuk duhet të ndërhyjë në pajisjet që janë instaluar për të siguruar shërbimet e telekomunikacionit dhe që i përkasin Operatorit, vetëm në qoftëse është instruktuar nga Operatori për të mirëmbajtjur apo për arsye riparimi.

7.2 Pajtimtari ka përgjegjësinë të mirëmbajë rrjetin e brëndshëm dhe pajisjet që lidhen me të dhe të sigurojë që punon sipas specifikimeve të prodhuesit dhe për qëllimin që përdoret. Operatori nuk mban asnjë përgjegjësi në rast se pajisja e Pajtimtarit/ose rrjeti i brëndshëm nuk funksionon mirë apo pengon rrjedhën normale të shërbimeve që ofrohen nga Operatori.

7.3 Në momentin e nënshkrimit të kontratës të dy palët bien dakort për instalimin e CPE(Pajisjet në Ambjentet e Pajtimtarit). Garancia e pajisjeve të instaluara tek Pajtimtari do të jetë efektive vetëm në rast se pajisjet janë instaluar dhe shitur nga Operatori dhe kjo garanci do të jetë në përputhje me kushtet dhe instruksionet e dhëna nga Prodhuesi.

7.4 Data fillimit të Garancisë së pajisjeve është data e shitjes sipas faturës përkatëse të pajisjes që është pronë e Operatorit. Në rast se Pajtimtari nuk mund të provojë disponimin e pajisjes përkatëse, të vënë në dispozicion nga Operatori, atëherë ai nuk mund të kompesohet me zëvendësimin e saj, në rasti në dëmtimit të pajisjes sipas kushteve të garancisë. Pajtimtari do të përdorë pajisjet në përputhje me Manualin e përdorimit të pajisjeve bashkangjitur.

7.5 Garancia nuk do të ketë efekt në rast Forcës Madhore, në rastet e problemeve të shkaktuara nga shkarkesat elektrike apo probleme të tjera që vijnë si pasojë e përdorimit në mënyrë të gabuar nga Pajtimtari dhe Operatori nuk mban përgjegjësi për pasojat e shkatuara si pasojë e këtyre problemeve. Pajtimtari nuk ka të drejtën të modifikojë, ndërhyjë ose të përdorë pajisjet përveç qëllimit të tyre në përputhje me Manualin e përdorimit dhe instruksioneve të Prodhuesit. Në rast se pajisjet dëmtohen Pajtimtari detyrohet të njoftojë Operatorin. Operatori nuk mban përgjegjësi për dëme të shkaktuara nga përdorimi i gabuar ose nga neglizhenca në përdorimin e pajisjes. Pajtimtari është i detyruar të kompesojë Operatorin për dëmtimin e pajisjeve si pasojë e neglizhencës ose përdorimit të papërshtatshëm. Pajtimtari është përgjegjës për çdo humbje, vjedhje, ose dëmtim të pajisjeve të përcaktuara në këtë kontratë.Pajtimtari detyrohet t`i përdorë këto pajisje në përputhje me udhëzimet e përdorimit të këtyre pajisjeve dhe të mos i përdorë ato në mënyrë të paligjshme dhe të mos i keqpërdorë. Pajtimtari është përgjegjës për tokëzimin e duhur të pajisjeve dhe për instalimin e duhur të kabllove të energjisë elektrike. Operatori nuk mban përgjegjësi në rast se pajisjet janë dëmtuar si pasojë e tokëzimit të bërë keq ose në mënyrë të papërshtatshme.

Të gjitha pajisjet e dhëna Pajtimtarit nga Operatori për sigurimin e shërbimit telefonisë dhe internetit janë pronë e Operatorit dhe i jepen në përdorim Pajtimtarit për gjithë kohëzgjatjen e shërbimit. Pajtimtari detyrohet që në rastin e zgjidhjes ose përfundimit të kontratës t`i kthejë Operatorit këto pajisje. Në rast se Pajtimtari nuk i kthen pajisjet e instaluara ose kur pajisjet janë të dëmtuara, atëherë ai është i detyruar të paguajë vlerën e pajisjeve të instaluara, sipas vlerës së tyre në proporcion me përdorimin e tyre. Vlera e pajisjeve caktohet në momentin e nënshkrimit të kontratës.

7.6 Në vijim të paragrafit të mësipërm, rrjedhimisht Operatori nuk mban përgjegjësi për pajisje të instaluara nga vete Pajtimtari dhe që konsiderohen pronë e tij.

7.7 Operatori garanton cilësinë e shërbimit të ofruar, që të jenë në përputhje të plotë me treguesit e paraqitur në informacionin e publikuar në faqen zyrtare të tij dhe të depozituar sipas parashikimeve ligjore në AKEP.

7.8 Operatori në cdo rast garanton, që në rast të kërkesës së Pajtimtarit për transferimin e linjës së shërbimit nga njëra adresë në një adresë tjetër, do të ofrojë kundrejt pagesës këtë shërbim, vetem në rast se ka zonë mbulimi për ofrimin e shërbimit të caktuar, në adresën e kërkuar nga Pajtimtari. Në asnjë rast tjetër Operatori nuk ka detyrim të ofrojë këtë shërbim dhe nuk mban përgjegjësi për realizimin e transferimit të shërbimit.

8 .SIGURIA E INFORMACIONIT DHE SISTEMEVE

8.1 Operatori është i detyruar që, individualisht ose kur është e nevojshme, në bashkëpunim me Operatorë të tjerë, të zbatojnë masa teknike dhe organizative, për të realizuar sigurinë e rrjeteve dhe/ose të shërbimeve të ofruara prej tyre;

8.2 Këto masa duhet të sigurojnë një nivel të mbrojtjes dhe sigurisë së përshtatshme ndaj rreziqeve të mundshme, të parashikuara;

8.3 Operatori është i detyruar të informojë përdoruesit e tyre për një rrezik të veçantë, mënyrën sesi rreziku mund të reduktohet nga përdoruesit , si dhe kostot e mundshme që duhet të mbulohen nga përdoruesi, nëse rreziku që ndodh është jashtë masave,që mund të marrë Operatori;

9.FORCA MADHORE

9.1 Asnjëra nga palët nuk mban përgjegjësi për mosekzekutimin e plotë apo të pjesshëm të detyrimeve që rrjedhin nga kjo kontratë kur kjo gjë ka ardhur si pasojë e forcave madhore ashtu sic parashikon ligji. Në këtë rast palët me mirëkuptim dhe miratim të përbashkët mund të caktojnë një afat tjetër të arsyeshëm për ekzekutimin e mëtejshëm të detyrimeve që rrjedhin nga kjo kontratë.

9.2 Në cdo rast ekzistenca e Forcës Madhore, nuk i jep të drejtën asnjërës prej palëve për të konsideruar si një të drejtë për ndërprerje të kontratës së nënshkruar dhe mospërmbushje të të drejtave dhe detyrimeve të rrjedhura prej saj. Kushtet e ofrimit të saj do të vijojnë ose do të shtyhen pas periudhës së ekzistencës së kushteve të Forcës Madhore.

9.3 Pavarësisht nga veprimi i Forcës Madhore, Operatori do të bëjë të gjitha përpjekjet e mundshme për të përmbushur sa më mirë detyrimet e tij që rrjedhin nga kjo Kontratë Shërbimi.

10.ZGJIDHJA E MOSMARËVESHJEVE

10.1 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindi nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj kontrate midis dy palëve, do të zgjidhen me bisedime dhe mirëkuptim të ndërsjelltë midis palëve në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Ankesat e pajtimtarit ne lidhje me vlerën e faturuar për shërbimin e ofruar apo në lidhje me cilësinë e shërbimit të ofruar i dërgohen Operatorit brenda 15(pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e faturës për shërbimin e ofruar. Operatori detyrohet të trajtojë cdo ankesë të pajtimtarit brenda 15(pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga marrja e saj, duke argumentuar ligjërisht me shkrim shërbimin e ofruar dhe duke trajtuar në detaje ankesën e pajtimtarit. Mjetet e komunkimit për trajtimin e ankesës së pajtimtarit do të jenë:

1)Postë zyrtare
2)Faks
3)Online

Operatori do të arshivojë dosjen përkatëse, me ankesat, kërkesat, sugjerimet dhe përgjigjiet e dhëna si dhe vendimet apo masat e marra në rastin e pajtimtarit, brenda 12 muajve.

Pajtimtari i cili nuk bie dakort me përgjigjien apo zgjidhjen e dhënë nga Operatori, ka të drejtën të fillojë procedurën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes duke iu drejtuar 1) AKEP sipas parashikimeve të Ligjit 54/2024 dhe Regullores Nr. 29 datë 29.05.2013 "Për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve Ndërmjet Pajtimtarëve dhe Sipërmarrësve te Komunikimeve Elektronike" 2)Gjykatës kompetente sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile.

10.2 Kur midis palëve nuk arrihet zgjidhja e çështjeve me mirëkuptim dhe kontrata shkelet nga njëra palë, pala tjetër i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë.

11 ZGJIDHJA E KONTRATES

11.1. Në rast të moszbatimit të Pajtimtarit të detyrimeve të përcaktuara në këtë kontratë, Operatori ka të drejtë t'i ndërpresë Pajtimtarit shërbimin që i ofrohet dhe të zgjidhë kontratën duke kërkuar dëmshpërblimin përkatës.

11.2 Operatori ka të drejtë që në cdo moment të zgjidhë kontratë me efekt të menjëhershëm në rast të shkeljes së detyrimeve thelbësore nga ana e Pajtimtarit, për shkaqe të arsyeshme si: shpërndarja e programeve pornografike, kryerja e veprimeve abuzive ose sulme abuzive, sulme hakerimi etj, duke i kërkuar Pajtimtarit edhe përgjegjësinë ndaj palëve të treta të cilat janë dëmtuar, si dhe shpërblimin e dëmit ndaj Operatorit për dëm të shkaktuar.

12 HARTIMI I KONTRATËS

12.1 Kushtet e Përgjithshme dhe të Vecanta të Kontratës së bashku me anekset përkatëse,janë pjesë integrale e kësaj kontrate, e cila hartohet në dy kopje të barazvlefshme. Çdo njëra prej tyre ka përmbajtje të njëjtë ligjore dhe secila palë do të mbajë një kopje.

Pajtimtari deklaron se me nënshkrimin e këtij formulari, i ka pranuar pa rezerva dhe nën vullnetin e tij të lirë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së Pajtimit.

Këto Kushte të Përgjithshme së bashku me Kushtet e Veçanta të Shërbimeve dhe Tarifave në fuqi, përbëjnë tërësinë e marrëveshjes ndërmjet palëve për ofrimin e shërbimeve të telekomunikacioneve prej Operatorit dhe faturimin përkatës të Pajtimtarit.

13 JURIDIKSIONI

Kjo kontratë është hartuar dhe udhëhiqet nga legjislacioni shqiptar. Të gjitha anekset janë pjesë integrale e saj duke u interpetuar sipas ligjit në tërësinë e kontratës.

Për cdo mosmarrëveshje midis palëve, fillimisht secila prej tyre do të kërkojë zgjidhje me mirëkuptim. Nëse zgjidhja nuk arrihet me vullnet dhe mirëkuptim, palët i drejtohet Gjykatës Kompetente. Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në rrugë gjyqësore, Gjykata kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

14 NJOFTIME

14.1Çdo njoftim për ndryshim të kushteve dhe termave të kësaj kontrate, kërkesë apo çdo lloj komunikimi i lejuar për t`u dhënë në bazë të kësaj kontrate ndërmjet palëve, do të bëhet me e-mail ose me shkrim në adresat e mëposhtme të deklaruara nga palët. Cdo komunikim i bërë në një nga format e cituara më lart do të konsiderohet zyrtar dhe i marrë në dijeni nga pala tjetër, më

dërgimin e saj, edhe në rast se refuzohet prej saj. Përgjegjësia e deklarimit është e palës që e ka bërë atë. Afatet e njoftimit fillojnë nga dita e dërgimit në emailin përkatës, apo në ditën e marrjes dijeni me postë, pavarësisht refuzimit për ta poseduar atë.

Të dhënat e deklaruara nga Pajtimtari e ngarkon këtë të fundit me përgjegjësinë e vërtetësisë së tyre. Në këtë përgjegjësi ai deklaron se është dakort që cdo e dhënë e vënë në dispozicion prej tij, të përdoret nga ana e Operatorit, sipas parashkimeve ligjore.

Pajtimtari do të informohet për të gjitha modifikimet dhe/ose ndryshimet e propozuara në kushtet e kontratës brenda një periudhe jo më vonë se 30 ditë përpara datës së propozuar për hyrjen në fuqi të këtyre modifikimeve dhe/ose ndryshimeve. Në rast se Pajtimtari nuk është dakort me kushtet e modifikuara dhe/ose ndryshuara, ka të drejtë të ndërpresë kontratën duke njoftuar me shkrim Operatorin, pa penalitete. Megjithatë zgjidhja e kontratës në këtë rast nuk do të heqë detyrimet që pajtimtari ka ndaj Operatorit në bazë të kësaj Kontrate, në lidhje me ofertën specifike të përfituar apo uljet e përfituara. Zgjidhja e kontrates nuk do të heqë detyrimet që pajtimtari ka në bazë të kontratës së vjetër.

Në rast se pajtimtari nuk njofton me shkrim Operatorin, sipas parashikimit të mësipërm, pajtimtari konsiderohet se i pranon në heshtje ndryshimet dhe efektet e ndryshimeve zbatohen nga data e hyrjes në fuqi të tyre pa qenë i detyrueshëm nënshkrimi i tyre (të një amendamenti apo kontratës së re) nga të dy palët. Palët kanë të drejtë të nënshkruajnë amendamentet apo kontratën e re, në çdo kohë para apo pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve.

Operatori:
Rr"Fabrika e Qelqit",Zona Kadastrale 8230,Nr.Pas 2/63, Tiranë
Tel +355 44 800 000
Faks : +355 44 800 001
E-mail info@trinet.al

Pajtimtari:
Adresa:
Tel:
e-mail:

15 PRIVATËSIA E KOMUNIKIMEVE DHE MBROTJA E TË DHENAVE PERSONALE

Operatori nuk do të nxjerri dhe shpërndajë mesazhet dhe të dhënat përkatëse të trafikut,të dhënat e vendndodhjes dhe të dhënat e nevojshme për të identifikuar pajtimtarin të cilat janë bërë të njohura për shkak të ofrimit të rrjeteve/shërbimeve.

Me qëllim mbrojtjen e konfidencialitetit, asnjë përgjim, ndërhyrje, regjistrim apo mënyra të tjera të ndërhyrjeve ose monitorimit të komunikimeve nga persona të tjerë veç dërguesit dhe marrësit do të lejohen, pa konsensusin e tyre të shprehur, përveç kur është e parashikuar me ligj. Pajtimtari pranon dhe miraton secilin prej veprimeve të mësipërme, për qëllim shtetërore dhe sipas ligjit.

Operatori është regjistruar si një administrator i të dhënave personale nga Komisioni për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Të dhënat lidhur me pajtimtarin nuk do t'u jepen palëve të treta, përveç se me konsensusin e pajtimtarit si konsumator ose ne rastet e parashikuara ne ligj. Pajtimtari pranon dhe miraton se të dhënat e tij mund të përdoren sipas parashkimeve ligjore.

Operatori do të ruajë informacionin sipas kushteve të vendosura në ligj, dhe nëse nuk është përcaktuar për një periudhë 24 muaj.

16.HYRJA NË FUQI E KONTRATËS

16.1 Kjo kontratë fillon efektet e saj nga data

OPERATORI	**PAJTIMTARI**
Albanian Satellite Communications sh.p.k	Emër /Mbiemër/Nënshkrimi
_____	_____

ANEKS NR.1

SHËRBIMET DHE TARIFAT

Në këtë seksion pasqyrohen shërbimet bazë të ofruara nga **Albanian Satellite Communications Sh.p.k** dhe të zgjedhura nga pajtimtari, tarifat përkatëse të shërbimeve, mënyra e tarifimit dhe parametrat teknike dhe cilësore të shërbimit.

1. PARAMETRA CILËSORË TEKNIKË

Shpejtësia e transmetimit të të dhënave:

- **Shpejtësia nominale/maksimale** e transmetimit të të dhënave deri ne:
  - Download:
  - Upload:
- Produkt me limit**:_____**Limiti konsumit **_____GB** shpejtesia e reduktuar **____**
- **Shpejtësia minimale e garantuar e transmetimit të të dhënave:**

  a) **Po, garantojmë minimalisht shpëjtësinë nominale/maksimale deri ne**

  b) **Jo, nuk garantojmë shpejtësi minimale pasi ofrimi i shërbimit bazohet në përpjekjet më të mira (best effort).**
- **vonesa në transmetim**, nëse ofruesi siguron një vlerë të caktuar;
- **devijimi në vonesën në transmetim**, nëse ofruesi siguron një vlerë te caktuar
- **norma e humbjes së paketave**, nëse ofruesi siguron një vlerë te caktuar
- **Rrjeti qendror dhe shërbimet e ofruara nga ai tek Pajtimtari janë të përbashkëta.**

2. PARAMETRA CILËSORË ADMINISTRATIVË:

- **koha për realizimin e lidhjes së aksesit në Internet, deri ne 2 ditë pune** ;
- **koha e riparimit të defekteve, deri në 3 (**ditë) pune;
- **koha e zgjidhjes së ankesave të Pajtimatereve brenda 15** (pesëmbëdhjetë) ditëve .

3. PAGESA MUJORE STANDARTE: **VLERË PAJISJE: _____**

4. E-MAIL FALAS

Adresë:

Password:

OPERATORI **PAJTIMTARI**

Albanian Satellite Communications sh.p.k Emër/Mbiemër/Nënshkrimi

_____ _____

ANEKS NR.2

UDHËZUES PËR ZGJIDHJEN E ANKESAVE

Ankesat mund të paraqiten:

- Nëpërmjet numrit të Kujdesit ndaj Pajtimtarit 044800000
- Nëpërmjet numrit të suportit teknik 044800003
- Nëpërmjet dyqaneve të Albanian Satellite Communications ku merret deklarim shkresor për ankesën.
- Nëpërmjet postës për ankesa të ndryshme.
- Me email në adresën: suport@trinet.al
- Me faks në numrin: 044800001

Afati i paraqitjes së ankesave është:

- Ankesat për "Difekte Teknike" dhe "Asistencë teknike për shërbimin e internet dhe të telefonisë "paraqiten në cdo kohë në pikat e kontaktit të sipër përmendura(shërbimi 24 orësh);
- Ankesat për vendimet apo veprimet e Operatorit për aksesin apo veprimit të kryer nga Operatori.
- Ankesat për faturim paraqiten në muajin pasardhës të faturës së ankimuar.
- Ankesa për mos-riparim të defekteve të paraqiten menjëherë pasi mbaron afati sipas pikave përkatëse të kontratës.
- Ankesat e tjera, të cdo lloji qofshin paraqiten sa më parë.
- Ankesat, në varësi nga natyra e tyre, shqyrtohen nga strukturat përkatëse e Operatorit mbështetur në të dhënat e marra nga Degët apo Sektorët e tjerë dhe konform rregullave bëhet analiza dhe zgjidhja e tyre, konform afateve të parashikuara në Kontratën e Pajtimit.
- Afati i Informimit me shkrim të Pajtimtarit mbi rezultatin e shqyrtimit të ankesave sipas pikave është brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e tyre.
- Operatori mban një regjistër të vecante për ankesat e paraqitura sipas pikave dhe përgjigjet e dhëna me shkrim duke i dhënë secilës një numër reference.

Pajtimtaret kanë të drejtë që, në përputhje me përcaktimet në kontratë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të ankohen në gjykatë për vendimin e marrë nga Operatori.

OPERATORI

Albanian Satellite Communications sh.p.k

_____

PAJTIMTARI

Emër/Mbiemër/Nënshkrimi

_____